



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 157

Tiranë – E enjte, 7 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 6.10.2021	Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit shtetëror..... 14587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 6.10.2021	Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore..... 14587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 6.10.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Berat të pasurive me nr. 14/124, nr. 14/125 dhe nr. 14/166, zona kadastrale 8501, Berat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar..... 14591
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 6.10.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”..... 14596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 6.10.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të 35 njësive individuale të banimit në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në kuadër të marrëveshjes së grantit të lidhur ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Austriak (ADA) dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për projektin “Përgjigje ndaj tërmeteve në Shqipëri”..... 14596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 572, datë 6.10.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”, të ndryshuar..... 14597

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 6.10.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	14597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 6.10.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni”, të ndryshuar.....	14598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 577, datë 6.10.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për subvencionimin e pagesave të qirasë për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019.....	14598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 6.10.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë, si pasojë e COVID-19”, të ndryshuar.....	14598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 6.10.2021	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i rrugës ‘Ramiz Aranitasi’, Fier”.....	14599
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 6.10.2021	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special” aplikuesit “ <i>Mediterranean Investment Group</i> ” sh.p.k.....	14601
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 402, datë 30.9.2021	Për miratimin e rregullores “Për hartimin e planit për detyrimin e zbarkimit të hedhurinave të disa formave të peshkimit fundor në det”..	14601
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 137, datë 19.7.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018, “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”.....	14604



VENDIM
Nr. 567, datë 6.10.2021

**PËR MËNYRËN E PROKURIMIT TË
MALLRAVE, PUNËVE E TË
SHËRBIMEVE, NË KUADËR TË
VEPRIMTARIVE TË CEREMONIALIT
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të pikës 4, të nenit 11, të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, dhe të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të prokurojnë mallra, punë dhe shërbime, sipas përcaktimeve të ceremonialit shtetëror të Republikës të Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në kuadër të organizimit të veprimtarive të veçanta dhe të përditshme me karakter protokollar e ceremonial.

2. Prokurimet për kategorinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i nënshtrohen procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, sipas dispozitave të legjislacionit për prokurimin publik, nëse vlera e përllogaritur për artikuj apo grup artikujsh, brenda një viti kalendarik, është nën kufirin e ulët monetar. Kjo procedurë prokurimi nuk zhvillohet me mjete elektronike.

3. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministria, për blerjen e biletave të udhëtimit dhe akomodimit të Kryeministrit, të Presidentit dhe të kryetarit të Kuvendit dhe personelit ndihmës e shoqërues të tyre, për vizitat zyrtare në kuadër të ceremonialit shtetëror, kontraktajnë drejtpërdrejt një ofrues shërbimesh që plotëson kushtet e konfidencialitetit. Në çdo rast, marrësi i shërbimit duhet të sigurohet që çmimet e shërbimeve të mos jenë mbi çmimet e tregut.

4. Vendimi nr. 358, datë 24.4.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 568, datë 6.10.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË
PUSHIMIT, ORËT SHITESË DHE
KOMPENSIMIN E TYRE NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, INSTITUCIONET E
PAVARURA DHE NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të neneve 76, 78, 79, 83, 85, 86, 87, 94, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kohëzgjatjes së punës dhe të pushimit, si dhe i rregullave në lidhje me orarin ditor të punës, festat zyrtare, pushimet, orët shtesë dhe kompensimin e tyre.

2. Ky vendim zbatohet për nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë (në vijim, i/të punësuarit), në:

a) institucionet e administratës shtetërore;



b) institucionet e pavarura;

c) njësitë e vetëqeverisjes vendore e institucionet të tyre të varësisë.

3. Për të punësuarit dhe/ose institucionet për të cilët/cilat ligjet e tyre specifike kanë përcaktime për kohëzgjatjen e punës e të pushimit, si dhe për rregullat në lidhje me orarin ditor të punës, pushimet, orët shtesë dhe kompensimin e tyre, ky vendim zbatohet për atë që nuk parashikohet ndryshe në këto akte.

4. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“institucion i administratës shtetërore”**, i njëjti kuptim i përcaktuar sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) **“institucion i pavarur”**, administrata e institucioneve të pavarura të parashikuara në Kushtetutë apo të krijuara me ligj dhe që i raportojnë Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale;

c) **“njësi e vetëqeverisjes vendore”**, i njëjti kuptim i përcaktuar sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore.

II. KOHËZGJATJA E PUNËS DHE ORËT SHITESË

1. Kohëzgjatja javore e punës për të punësuarit e përcaktuar në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, është 40 (dyzet) orë në javë.

2. Orari ditor i punës për të punësuarit, në:

a) institucionet e administratës shtetërore, si rregull, fillon çdo ditë në orën 8:00 dhe përfundon në orën 16:30, ndërsa ditën e premte fillon në orën 8:00 dhe përfundon në orën 14:00;

b) institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit.

3. Për institucionet e administratës shtetërore, në raste të veçanta dhe për arsye objektive, orari ditor i punës mund të ndryshohet me urdhër të Kryeministrit, por për një periudhë jo më të gjatë se 3 (tre) muaj.

4. Brenda orarit ditor të punës, të punësuarit mund të kryejnë veprimtari mësimdhënieje pas miratimit nga titullari i institucionit, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompensohen në orë pune, brenda javës, pas orarit ditor të punës. I punësuarit që angazhohet në mësimdhënie detyrohet të depozitojë, pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku është i

punësuar, kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.

5. Për institucionet e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, për të cilat, për shkak të natyrës së punës, puna duhet të organizohet me turne apo i punësuarit duhet të kryejë punë nate, orari ditor i punës përcaktohet nga vetë institucioni, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës.

6. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji llogaritet, mesatarisht, me 174 orë pune. Për efekt të llogaritjes së pagës ditore, muaji llogaritet, mesatarisht, me 22 ditë pune.

7. Me kërkesë të eprorit direkt dhe me miratimin e titullarit të institucionit, të punësuarit mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës.

8. Të punësuarit, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen vetëm me pushim, të barabartë me:

a) orët shtesë plus 25 (njëzet e pesë) për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune; apo

b) orët shtesë plus 50 (pesëdhjetë) për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.

9. Të punësuarit, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompensohen me pushim të barabartë me:

a) orët shtesë plus 25 (njëzet e pesë) për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune; apo

b) orët shtesë plus 50 (pesëdhjetë) për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.

10. Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, i punësuarit, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar:

a) në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 (njëzet e pesë) për qind shtesë të kësaj page;

b) ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00–6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 (pesëdhjetë) për qind shtesë të kësaj page.

11. Në kuptim të këtij vendimi, veprimtari operacionale, si rregull, konsiderohen ato veprimtari që kanë kohëzgjatje të pandërprerë (sistem 24-orësh/gatishmëri). Për raste të tjera



specifike merret mendimi i detyrueshëm nga ministria përgjegjëse për financat dhe Departamenti i Administratës Publike.

12. Titullari i institucionit detyrohet t'i japë të punësuarit pushimin, sipas përcaktimeve në pikat 8 dhe 9, të këtij kreu, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë.

13. Për të kryer një detyrë të caktuar jashtë kohës normale të punës, titullari i institucionit miraton urdhrin përkatës për detyrën që duhet të kryhet, kohëzgjatjen e saj dhe të punësuarin apo të punësuarit që ngarkohet/n me kryerjen e kësaj detyre. Njësitë e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin e të punësuarit, që caktohet të punojë jashtë kohës normale të punës, marrin masat për të siguruar realizimin e detyrës së caktuar, si dhe për të përcaktuar kohën e kryerjes së pushimit të përlogaritur, sipas pikave 8 dhe 9, të këtij kreu.

14. Si rregull, puna kryhet në ambientet e institucionit. Kur është e mundur dhe pa cenuar cilësinë e realizimit të punës nga i punësuar, si dhe cilësinë e punës së institucionit, i punësuar e realizon punën e tij tërësisht nëpërmjet telefonës, apo ka të drejtën ta realizojë punën e tij pjesërisht nëpërmjet telefonës, duke respektuar përcaktimet e Kodit të Punës dhe të marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim, midis tij dhe titullarit/sekretarit të përgjithshëm, ku pjesë e detyrueshme e saj duhet të jetë dhe procedura e kontrollit të realizimit të punës nëpërmjet telefonës. Të punësuarit, që do të kryejnë punën e tyre tërësisht apo pjesërisht nëpërmjet telefonës, u nënshtrohen të gjitha rregullave të vlerësimit të rezultateve në punë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënien e tyre të punësimit.

III. PUSHIMET

1. Si rregull, ditët e pushimit javor janë dita e shtunë dhe e diel, me përjashtim të rasteve kur, me vendim të Këshillit të Ministrave apo në kontratën kolektive, është përcaktuar ndryshe.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 (katër) javë kalendarike. Koha e kryerjes së pushimit vjetor të paguar përcaktohet nga titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm, sipas kërkesës të të punësuarit, duke mos cenuar vijueshmërinë e punës.

3. I punësuar ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor të paguar edhe në periudha të ndryshme e të ndara, por këto periudha nuk mund

të jenë më të shkurtra se 1 (një) javë kalendarike pa ndërprerje.

4. Pushimi vjetor i paguar duhet të jepet gjatë vitit kalendarik ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit kalendarik pasardhës. Në rastet kur punëdhënësi nuk miraton kryerjen e pushimeve vjetore apo i punësuar nuk i merr pushimet vjetore, të plota apo të pjesshme, ai ka të drejtë t'i kryejë ato brenda tre vjetëve nga dita në të cilën i lind kjo e drejtë, duke zbatuar të njëjtën procedurë të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu.

5. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar, kur i punësuar nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënies financiare të punës. Ky rregull zbatohet si në rastet e fillimit të marrëdhënies së punës për herë të parë gjatë vitit kalendarik përkatës, ashtu edhe në rastet e përfundimit të marrëdhënies së punës.

6. Në rastet kur i punësuar, brenda vitit kalendarik, ka kryer lejen e barrë lindjes, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar llogaritet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen efektive të punës pa përfshirë periudhën e kësaj lejeje.

7. Pushimi vjetor me pagesë shtyhet, kur:

a) gjatë periudhës së këtij pushimi, i punësuar ka qenë i shtruar në spital ose ka qëndruar në shtëpi, për shkak sëmundjeje ose aksidenti, të vërtetuar me raport mjekësor, për aq ditë sa ka zgjatuar shtrimi në spital apo raporti mjekësor. Në këtë rast i punësuar duhet të njoftojë eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit për shtyrjen e pushimit vjetor të paguar;

b) dita e festës zyrtare bie në periudhën e këtij pushimi, për aq ditë sa ka qenë festa zyrtare.

8. Pushimet vjetore të paguara, përfshirë rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar për arsye të paparashikuara dhe kryerja e pushimeve vjetore është e pamundur. Në këtë rast, i punësuar, të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, ka të drejtë të përfitojë një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, është e pavlefshme.

9. Llogaritja e shpërblimit, e përcaktuar në pikën 8, të këtij kreu, bëhet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, në të cilin të punësuarit i ka përfunduar marrëdhënia e



punës dhe ai duhet të jepet brenda të njëjtit vit kalendarik. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, shpërblimit të llogaritur në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, i shtohet edhe shpërblimi që i takon për pushimet e pakryera dhe të mbartura nga vitet e mëparshme.

10. Pushimi vjetor i paguar, që i është dhënë të punësuarit në një vend pune, llogaritet në kohën e pushimit vjetor të paguar, kur ai caktohet në një vend tjetër pune.

11. Paga e dhënë për pushimin vjetor të paguar është ajo që ka i punësuarit në çastin e marrjes së saj dhe i jepet atij në fillim të pushimit vjetor.

12. I punësuarit ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet, si më poshtë vijon:

- a) martesë e tij – 5 (pesë) ditë;
- b) lindja e fëmijës për bashkëshortin/bashkëjetuesin – 3 (tri) ditë;
- c) vdekja e bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindërve, gjyshërve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij – 5 (pesë) ditë.

13. Përveç sa është parashikuar në pikën 12, të këtij kreu, nëpunësi civil ka të drejtën e pushimit të paguar për 5 (pesë) ditë për përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve akademikë apo diplomave të studimeve të ciklit të tretë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë, të lidhur me punën që kryen.

14. I punësuarit ka të drejtë që të përfitojë pushim pa të drejtë page, si më poshtë vijon:

a) për të punësuarin, marrëdhënia e punës të të cilit rregullohet nëpërmjet Kodit të Punës apo me legjislacion tjetër të ndryshëm nga legjislacioni për nëpunësin civil, në rastet e sëmundjeve të rënda të anëtarëve të familjes, bashkëjetuesit, prindërve ose pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor;

b) për nëpunësin civil, për arsye shëndetësore apo të tjera arsye personale, që lidhen me vetë nëpunësin civil, fëmijët, bashkëshortin/bashkëjetuesin apo prindërit.

15. Kohëzgjatja e pushimit pa të drejtë page, sipas pikës 14, të këtij kreu, përcaktohet nga titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm, me propozimin e eprorit direkt. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha pushimeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më e gjatë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

IV. PUNA NË DITËT E FESTAVE ZYRTARE DHE TË PUSHIMIT JAVOR

1. Si rregull, ditët e festave zyrtare janë ditë pushimi. I punësuarit gëzon të drejtën e pagës në këto ditë.

2. Kur festa zyrtare bie në ditët e punës dhe, me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive, është vendosur të punohet, puna e kryer ditën e festës zyrtare kompensohet me një shtesë page jo më pak se 25 (njëzet e pesë) për qind dhe me një pushim të pagueshëm të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare. Ky pushim merret një javë para ose pas kryerjes së saj.

3. Kur festa apo festat zyrtare bie/bien në ditën apo ditët e pushimit javor, atëherë pushimi shtyhet në ditën apo ditët pasardhëse të punës.

V. VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE NË RASTE TË VEÇANTA

1. Gjatë periudhës së gjendjes së epidemive, të përcaktuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi:

a) institucionet e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, janë të detyruara të realizojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe telepunës (puna në distancë *on-line*), me qëllim respektimin e rregullave të distancimit social ndërmjet të punësuarve, të përcaktuara nga Instituti i Shëndetit Publik, bazuar në sipërfaqen e institucionit;

b) për realizimin e detyrimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, institucionet duhet të përcaktojnë në mënyrë të detajuar e të qartë grafikun e të punësuarve që do të punojnë në ambientet e institucionit dhe të atyre që do të kryejnë detyrat nëpërmjet telepunës. Grafiku duhet të miratohet nga sekretari i përgjithshëm/titullari i institucionit;

c) në përcaktimin e të punësuarve që do të kryejnë detyrat nëpërmjet telepunës, institucionet duhet të bazohen në:

i. vlerësimin e llojit të detyrave që ushtrojnë të punësuarit;

ii. evidentimin e rasteve të të punësuarve me patologji të ndryshme, të cilët janë më të rrezikuar në rast infektimi;

iii. evidentimin e të punësuarve që kanë në kujdestari fëmijë deri në moshën 14 (katërmëdhjetë) vjeç.

Për rastet e parashikuara në nënndarjet “ii” dhe



“iii”, të kësaj shkronje, përpara miratimit të grafikut, institucionet duhet të konsultohen me të punësuarit, me qëllim që të mundësohet realizimi i detyrave;

ç) puna nëpërmjet telepunës ka të njëjtën kohëzgjatje kohore, si edhe puna në ambientet e punës së institucionit.

2. Në rastet e kufizimeve të orarit të mësimin gjatë periudhave të gjendjeve të epidemive:

a) orari i punës për të punësuarit e përcaktuar në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, që janë prindër apo kujdestarë ligjorë të fëmijëve që frekuentojnë/ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, për ditët kur ata duhet të kryejnë detyrat në ambientet e institucionit, sipas grafikut të miratuar, përcaktohet nga titullari i institucionit;

b) orari i punës për këta të punësuar gjatë kësaj periudhe përcaktohet në varësi të orarit që fëmija/fëmijët e tyre do të frekuentojnë mësimin, por duke siguruar që kohëzgjatja maksimale e punës të mos ndryshojë.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës shtetërore dhe secili institucion i pavarur e njësi e vetëqeverisjes vendore për institucionin e tyre të miratojnë, rast pas rasti, rregullat e procedurat standarde të punës të harmonizuara, në përputhje me përcaktimet e kreut V, të këtij vendimi, dhe udhëzimet e dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik apo institucione/organe të tjera të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi për përcaktimin e rregullave në rastet e epidemive.

2. Pushimi vjetor i paguar, pushimet e tjera dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të të punësuarit.

3. Urdhri nr. 80, datë 17.11.2020, i Departamentit të Administratës Publike, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020–2021”, dhe urdhrat/udhëzimet e institucioneve të pavarura dhe njësite të vetëqeverisjes vendore, të miratuara në zbatim të pikave 4, 5 dhe 6, të kreut III, të vendimit nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet e administratës shtetërore”, të

ndryshuar, vazhdojnë të jenë në fuqi deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

4. Vendimi nr. 511, datë 24.10.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 569, datë 6.10.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT TË PASURIVE ME NR. 14/124, NR. 14/125 DHE NR. 14/166, ZONA KADASTRALE 8501, BERAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, nga Shërbimi Informativ i Shtetit në pronësi të Bashkisë Berat, të pasurive me nr. 14/124, nr. 14/125 dhe nr. 14/166, zona kadastrale 8501, Berat, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative dhe për interes vendor të Bashkisë Berat.

2. Prona me emërtimin “Drejtoria SHISH Berat”, ndodhur në zonën kadastrale 8501, me numra pasurie 14/124, 14/125 dhe 14/166, Berat,



hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Berat i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t'i

tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Bashkia Berat, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

1.FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Mbeshtetur ne inventarin e pronave te vecanta te tipit Infrastrukture dhe sherbime publike)

Bashki Berat

Fusha e përdorimit të Pronës: **Administratë**

Identifikoi:

Meleqe Spahiu (Drejtor e Emergjencave Pronave dhe Transportit
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi:

Ervin Demo (Kryetar i Bashkisë Berat)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)


A				B				C		
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa truall (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin do perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i përdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8501 BR J-3	14/124	Godine 2 kt	zyrat e SHISH Berat	384	128	256	Zyra per per administraten lagjes nr.1 Berat	Bashkia Berat	Bashkia Berat ne pronesi
2	8501 BR J-3	14/125	Truall	Per zyrat e SHISH Berat	257	257	0	Truall per zyrat e administrates dhe per investime ne infrastrukture lagjes nr.1 Berat	Bashkia Berat	Bashkia Berat ne pronesi
3	8501 BR J-3	14/166	Godine	Per zyrat e SHISH Berat	95	95	95	Godine per zyrat e administrates lagjes nr.1 Berat	Bashkia Berat	Bashkia Berat ne pronesi



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME BERAT REGJISTRUES Osiana Zaimi	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE <u>8501</u> NR. I PASURISE: <u>14/166</u> VOL. <u>16</u> FQ. <u>246</u> INDEKSI I HARTES: <u>BR-J-3</u> SHKALLA: <u>1:636</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>BERAT</u> Q/F <u>BERAT</u> Rr/L: P/G SH <u>-1</u> K <u>—</u> Ap B. KUFIZIMET V. _____ L. _____ J. _____ P. _____ C. PRONARI SH.I.SH BERAT D. Data: 10/4/2021 Ora: 3:24:26PM
--	---

X: 410776.433
Y: 4508390.825X: 410898.507
Y: 4508390.825X: 410776.433
Y: 4508289.798X: 410898.507
Y: 4508289.798



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI : SHTET		DATE 11.02.2021		QELIMI PER REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA BASHKIA : BERAT DVASHK : BERAT ZONA KADASTRALE : 8501 NUMRI PASURISE 14/124 INDEX HARTE : BR; J-3																																								
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE : TRUALL SIP.PASURISE = 128.0 m² SIPERFAQE GJURMES NDETIMIT = 128.0 m² NUMRI KATEVE : 2																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 495141 Y 4507721 X 495278 Y 4507721																																								
BR; J-3		SH 1:500		SHPJEGUES KUFIRI SIPAS GIENDJES FAKTIKE SIPERFAQE = 128.0 m ²																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td></td> <td>14/125</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td></td> <td>14/358, 14/125</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td></td> <td>14/123</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td></td> <td>14/125</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI			14/125			2	JUG			14/358, 14/125			3	LINDJE			14/123			4	PERENDIM			14/125		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI			14/125																																				
2	JUG			14/358, 14/125																																				
3	LINDJE			14/123																																				
4	PERENDIM			14/125																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: ANXHELO DHIMO LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: <i>Specialisti Berat</i> NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA: <i>[Signature]</i> REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJES/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: <i>Bashkia Berat</i> NENSHKRIMI: <i>Kryetari Ervin Dema</i>																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI : SHTET		DATE 11.02.2021		QELIMI PER REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA BASHKIA : BERAT		DVASHK : BERAT		ZONA KADASTRALE : 8501																																				
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE : TRUALL		SIP.PASURISE = 91.2 m ²		NUMRI PASURISE 14/125																																				
		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT		INDEX HARTE : BR; J-3																																				
				NUMRI KATEVE																																				
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
8501 BERAT BR; J-3 SH 1:500																																								
SHPJEGUES KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE SIPERFAQE = 91.2 m ²																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td></td> <td>14/357, 14/296</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td></td> <td>14/360</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td></td> <td>14/166</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td></td> <td>14/124, 14/123</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI			14/357, 14/296			2	JUG			14/360			3	LINDJE			14/166			4	PERENDIM			14/124, 14/123		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI			14/357, 14/296																																				
2	JUG			14/360																																				
3	LINDJE			14/166																																				
4	PERENDIM			14/124, 14/123																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: ANXHELO DHIMO LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: <i>Specialisti i Beratit</i> NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA: <i>AAW</i> REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI / VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: <i>Bashkia Berat</i> NENSHKRIMI: <i>Erjefari</i> <i>Elvin Demo</i>																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



VENDIM

Nr. 570, datë 6.10.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 1134, DATË 24.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË
BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN
E BASHKISË TIRANË SI NJËSI
ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 1, të vendimit nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “... TIP në RSU nr. 1 (nr. 16)...”, zëvendësohet me “... TIP në RSU nr. 1 (nr. 19)...”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM

Nr. 571, datë 6.10.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË 35 NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT NË
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN,
BASHKIA MIRDITË, NË KUADËR TË
MARRËVESHJES SË GRANTIT TË
LIDHUR NDËRMJET AGJENCISË SË
ZHVILLIMIT AUSTRIAK (ADA) DHE
MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN, PËR PROJEKTIN
“PËRGJIGJE NDAJ TËRMETEVE
NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 35 njësive individuale të banimit brenda zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në zbatim të marrëveshjes së grantit të lidhur, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Austriak (ADA) dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për projektin “Përgjigje ndaj tërmeteve në Shqipëri”.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e



Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 572, datë 6.10.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 2, shifra “... 5 130 260 797 (pesë miliardë e njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH...”, zëvendësohet me “... 5 001 173 797 (pesë miliardë e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH...”;

b) në shkronjën “a”, të pikës 2, shifra “... 4 125 706 878 (katër miliardë e njëqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH...” zëvendësohet me “... 3 996 619 878 (tre miliardë e

nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH...”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 573, datë 6.10.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 43/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nënpikën 2.3, të pikës 2, “Përdorimi i sallës VIP të aeroportit”, të kapitullit V, të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalëve “ish-President i Republikës” shtohen “ish-kryetar i Kuvendit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 574, datë 6.10.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 475, DATË 8.6.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-s
NË LETONI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 5, të vendimit nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data 31 dhjetor 2021 ndryshohet dhe bëhet 31 dhjetor 2023.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Arben Ahmetaj****VENDIM****Nr. 577, datë 6.10.2021**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË, PËR SUBVENCIONIMIN E
PAGESAVE TË QIRASË PËR FAMILJET E
MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E
FATKEQËSIVE NATYRORE, TËRMETIT
TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar; dhe të aktit normativ nr. 37, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në programin e strehimit, shtohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”, përkatësisht, në produktin për pagesat e subvencionimit të qirasë për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019.

2. Efekti financiar, prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Arben Ahmetaj****VENDIM****Nr. 578, datë 6.10.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 608, DATË 29.7.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT,
KRITERET DHE RREGULLAT PËR
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES
SË PUNËSIMIT NËPËRMJET
PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË
TË PAPUNË, SI PASOJË E COVID-19”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11; të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, të kreut I, fjalët "... 31 dhjetor 2020." zëvendësohen me "... 30 qershor 2021."

b) Në pikën 1, të kreut V, fjalët "... deri më 31 dhjetor 2021." zëvendësohen me "... deri në 3 vjet nga fillimi i zbatimit të saj."

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 579, datë 6.10.2021

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I
RRUGËS 'RAMIZ ARANITASI', FIER"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i rrugës 'Ramiz Aranitasi', Fier".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 9 637 882 (nëntë milionë e

gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 637 882 (nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2021, i miratuar për Bashkinë Fier.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim pranë Bashkisë Fier.

8. Bashkia Fier të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Fier.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I RRUGËS ‘RAMIZ ARANITASI’, FIER”

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truall i prekur (m ²)	Çmimi truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Miranda Ibrahim Kodheli	truall + ndërtesë	8531	10/681	24	24	12,458	298,992	24	24	1,096,944	1,395,936	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017
2	Muharem Gurguri, Vllaznim Gurguri dhe Emine Xhemal Gurguri	truall	8534	8/184	51.50	51.50	12,893	663,990				663,990	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017
3	Muharem Gurguri, Vllaznim Gurguri dhe Emine Xhemal Gurguri	truall	8534	8/365	136	136	12,893	1,753,448				1,753,448.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017
4	Muharem Gurguri, Vllaznim Gurguri dhe Emine Xhemal Gurguri	truall	8534	8/366	201.80	201.80	12,893	2,601,807				2,601,807.4	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Avdulla Ahmet Agalliu	ndërtesë	8534	8/110-ND				-	37.20	37.20	1,438,896	1,438,896	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017
6	Kadri Habib Nuhu	truall	8534	6/442	96	96	12,893	1,237,728				1,237,728	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017. Në seksionin E të kartelës janë kufizuar veprimet, me urdhër nr. 6566, datë 25.8.2015.
7	Sokol Dylber Tomori dhe Manushaqe Filat Tomori	truall + ndërtesë	8534	4/326	12	12	12,893	154,716	12	12	391,361	546,077	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 28.4.2017
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT						521	12,893	6,710,681		73	2,927,201	9,637,882	



VENDIM
Nr. 582, datë 6.10.2021

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË “INVESTITOR NË
STRUKTURË
AKOMODUESE ME 5 YJE, STATUS
SPECIAL” APLIKUESIT
“MEDITERRANEAN INVESTMENT
GROUP” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special” aplikuesit “*Mediterranean Investment Group*” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

URDHËR
Nr. 402, datë 30.9.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR HARTIMIN E PLANIT PËR
DETYRIMIN E ZBARKIMIT TË
HEDHURINAVE TË DISA FORMAVE
TË PESHKIMIT FUNDOR NË DET”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 98, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për hartimin e planit për detyrimin e zbarkimit të hedhurinave të disa formave të peshkimit fundor në det”, bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

RREGULLORE
PËR HARTIMIN E PLANIT PËR
DETYRIMIN E ZBARKIMIT TË
HEDHURINAVE TË DISA FORMAVE TË
PESHKIMIT FUNDOR NË DET

Neni 1
Detyrimi i zbarkimit

Të gjitha zëniet e specieve për të cilat janë përcaktuar kuota, si dhe peshkimi i specieve për të cilat janë përcaktuar madhësitë minimale sipas shtojcës III të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402/2013, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të ndryshuar, që është kryer gjatë aktivitetit të peshkimit në ujërat territoriale shqiptare ose nga një anije peshkimi me flamur shqiptar jashtë ujërave territoriale shqiptare, në ujërat që nuk janë nën sovranitetin ose juridiksionin e vendeve të treta dhe që mbahen në bordin e anijes së peshkimit, regjistrohen, zbarkohen dhe llogariten si pjesë e kuotave, kur është e zbatueshme, përveç rasteve kur përdoren si karrem i gjallë.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë rregullore termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Deti Mesdhe”, ujërat detare të Mesdheut në lindje të meridianit 5°362 perëndimor;

b) “Nënzona gjeografike të GFCM-KPPM”, nënzona gjeografike e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, sipas shtojcës VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të ndryshuar;

c) “Deti Mesdhe Perëndimor”, nënzona gjeografike e KPPM-së 1, 2, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11.1, 11.2 dhe 12;



ç) “Deti Adriatik”, nënzona gjeografike e KPPM-së 17 dhe 18;

d) “Deti Mesdhe Juglindor”, nënzona gjeografike e KPPM-së 14, 15, 16, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Neni 3

Përcaktimi i porteve dhe kriteret e zbatimit

1. Portet e peshkimit për zbatimin e detyrimit të zbarkimit janë:

- a) Porti i Peshkimit Durrës;
- b) Porti i Peshkimit Shëngjin;
- c) Porti i Peshkimit Vlorë;
- ç) Porti i Peshkimit Sarandë.

2. Zbarkimet lejohen të shkarkohen çdo ditë të javës në çdo orë, në portet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Vendet e shkarkimit dhe të zbarkimeve janë bankinat e porteve të peshkimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Procedurat e inspektimit dhe të mbikëqyrjes kryhen sipas parashikimeve të përcaktuara në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.

Neni 4

Përjashtimet nga detyrimi i zbarkimit të lidhura me aftësinë e species për të mbijetuar

1. Speciet e mëposhtme, të cilat sipas të dhënave shkencore, zotërojnë një shkallë të lartë mbijetese, përjashtohen nga detyrimi për t'u zbarkuar:

a) Gjuhëz kanali (*Solea solea*) e zënë me rrjeta fundore me shfletim (TBB) në Detin Adriatik deri më 31 dhjetor 2022;

b) Skampi (*Nephrops norvegicus*) i zënë me rrjeta fundore (OTB, OTT, PTB, TBN, TBS, TB, OT, PT, TX) në Mesdheun Perëndimor, Detin Adriatik dhe Mesdheun Juglindor;

c) Skampi (*Nephrops norvegicus*) i zënë me kurthe (FPO, FIX), në Mesdheun Perëndimor, Detin Adriatik dhe Mesdheun Juglindor deri më 31 dhjetor 2022;

ç) Astakua (*Homarus gammarus*) e zënë me mrezha dhe njica fikse (GNS, GN, GND, GNC, GTN, GTR, GEN) dhe kurthe (FPO, FIX) në Mesdheun Perëndimor, Detin Adriatik dhe Mesdheun Juglindor;

Faqe | 14602

d) Aragostat (*Palinuridae*) të zëna me mrezha dhe njica fikse (GNS, GN, GND, GNC, GTN, GTR, GEN) dhe kurthe (FPO, FIX) në Mesdheun Perëndimor, Detin Adriatik dhe Mesdheun Juglindor.

2. Gjuhëza e kanalit (*Solea solea*), skampi (*Nephrops norvegicus*), astakua (*Homarus gammarus*) dhe aragostat (*Palinuridae*) të zëna sipas specifikimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, lëshohen menjëherë në zonën ku janë peshkuar.

Neni 5

Përjashtimi mbi minimumin e lejuar

1. Si përjashtim i nenit 4 të kësaj rregulloreje, në Detin Adriatik mund të hidhen speciet në sasitë e përcaktuara si më poshtë:

a) Merluci (*Merluccius merluccius*) dhe barbuni (*Mullus spp.*), maksimum 6% më 2021-shin dhe 2022-shin dhe maksimum 5% më 2023-shin të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet fundore;

b) Merluci (*Merluccius merluccius*) dhe barbuni (*Mullus spp.*), maksimum 1% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet që peshkojnë me mrezha dhe njica fikse;

c) Merluci (*Merluccius merluccius*) dhe barbuni (*Mullus spp.*), maksimum 1% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet fundore që përdorin rrjeta me shfletim (TBB);

ç) Gjuhëz kanali (*Solea solea*), maksimum 3% të zënieve totale vjetore për anijet fundore;

d) Levreku (*Dicentrarchus labrax*), sargu bishtëzi (*Diplodus annularis*), sharan (*Diplodus puntazzo*), sargu (*Diplodus sargus*), sargua (*Diplodus vulgaris*), kern (*Epinephelus spp.*), murra (*Lithognathus mormyrus*), mormuri i egër (*Pagellus acarne*), spalca e kuqe (*Pagellus bogaraveo*), pagri (*Pagellus erythrinus*), pagri (*Pagrus pagrus*), kerr fundi (*Polyprion americanus*), koce (*Sparus aurata*) karkaleci rozë i thellësisë (*Parapenaeus longirostris*), maksimum 5% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet fundore;

dh) Levreku (*Dicentrarchus labrax*), sargu bishtëzeze (*Diplodus annularis*), sharan (*Diplodus puntazzo*), sargu (*Diplodus sargus*), sargua (*Diplodus vulgaris*), kern (*Epinephelus spp.*), murra (*Lithognathus mormyrus*), mormuri i egër (*Pagellus acarne*), spalca e kuqe (*Pagellus bogaraveo*), pagri (*Pagellus erythrinus*), pagri (*Pagrus pagrus*), kerr fundi (*Polyprion americanus*), gjuhëz kanali (*Solea solea*), koce (*Sparus aurata*),



maksimum 3% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet që peshkojnë me mrezha dhe njica fikse;

e) Levreku (*Dicentrarchus labrax*), sargu bishtëzë (*Diplodus annularis*), sharan (*Diplodus puntazzo*), sargua (*Diplodus sargus*), sargua (*Diplodus vulgaris*), kern (*Epinephelus spp.*), murra (*Lithognathus mormyrus*), mormuri i egër (*Pagellus acarne*), pagri (*Pagellus erythrinus*), pagri (*Pagrus pagrus*), kerr fundi

(*Polyprion americanus*), gjuhëz kanali (*Solea solea*), kocë (*Sparus aurata*), maksimum 1% të zënieve totale vjetore të këtyre specieve për anijet që peshkojnë me grepa dhe pallangarë;

ë) Açuga (*Engraulis encrasicolus*), sardele (*Sardina pilchardus*), skumbri (*Scomber spp.*), stavridh (*Trachurus spp.*), maksimum 5% i zënieve jo objekt peshkimi totale vjetore të këtyre specieve për anijet fundore.

SHTOJCA 1

1. Deti Adriatik

Speciet	Kodi i veglës së peshkimit	Veglat e peshkimit	Detyrimi i zbarkimit
Merluci (<i>Merluccius merluccius</i>) Barbuni (<i>Mullus spp</i>) kodit FAO: MUT, MUR, MUX Skampi (<i>Nephrops norvegicus</i>) Karkaleci rozë i thellësisë (<i>Parapaneus longirostris</i>) Levrek (<i>Dicentrarchus labrax</i>) Sargua bishtëzi (<i>Diplodus annularis</i>) Sharan (<i>Diplodus puntazzo</i>) Sargua (<i>Diplodus sargus</i>) Sargua (<i>Diplodus vulgaris</i>) Kern (<i>Epinephelus spp.</i>) Murra (<i>Lithognathus mormyrus</i>) Mormuri i egër (<i>Pagellus acarne</i>) Spalcë e kuqe (<i>Pagellus bogaraveo</i>) Pagri (<i>Pagellus erythrinus</i>) Pagri (<i>Pagrus pagrus</i>) Kerr fundi (<i>Polyprion americanus</i>) Gjuhëz kanali (<i>Solea vulgaris</i>) Kocë (<i>Sparus aurata</i>) Zënie jo objekt peshkimi: Açuge (<i>Engraulis encrasicolus</i>) Sardele (<i>Sardina pilchardus</i>) Skumbri (<i>Scomber spp.</i>) Stavridh (<i>Trachurus spp.</i>)	OTB, OTT, PTB, TBN, TBS, TB, OT, PT, TX	Të gjitha rrjetat fundore	Të gjitha zëniet janë objekt i detyrimit të zbarkimit
Merluci (<i>Merluccius merluccius</i>) Levrek (<i>Dicentrarchus labrax</i>) Sargu bishtëzi (<i>Diplodus annularis</i>) Sharan (<i>Diplodus puntazzo</i>) Sargua (<i>Diplodus sargus</i>) Sargua (<i>Diplodus vulgaris</i>) Kern (<i>Epinephelus spp.</i>) Murra (<i>Lithognathus mormyrus</i>) Mormuri i egër (<i>Pagellus acarne</i>) Spalcë e kuqe (<i>Pagellus bogaraveo</i>) Pagri (<i>Pagellus erythrinus</i>)	LL, LLS, LLD, LX, LTL, LHP, LHM	Të gjitha grepat dhe pallangarët	Të gjitha zëniet janë objekt i detyrimit të zbarkimit
Pagri (<i>Pagrus pagrus</i>) Kerr fundi (<i>Polyprion americanus</i>) Gjuhëz kanali (<i>Solea vulgaris</i>) Kocë (<i>Sparus aurata</i>)			
Merluci (<i>Merluccius merluccius</i>) Barbuni (<i>Mullus spp</i>) kodit FAO: MUT, MUR, MUX Gjuhëz kanali (<i>Solea vulgaris</i>) Astakua (<i>Homarus gammarus</i>)	GNS, GN, GND, GNC, GTN, GTR, GEN	Të gjitha mrezha dhe njica fikse	Të gjitha zëniet janë objekt i detyrimit të zbarkimit



Aragosta (<i>Palinuridae</i>) Levrek (<i>Dicentrarchus labrax</i>) Sargu bishtëzi (<i>Diplodus annularis</i>) Sharan (<i>Diplodus puntazzo</i>) Sargu (<i>Diplodus sargus</i>) Sargua (<i>Diplodus vulgaris</i>) Kern (<i>Epinephelus spp.</i>) Murra (<i>Lithognathus mormyrus</i>) Mormuri i egër (<i>Pagellus acarne</i>) Spalcë e kuqe (<i>Pagellus bogaraveo</i>) Pagri (<i>Pagellus erythrinus</i>) Pagri (<i>Pagrus pagrus</i>) Kerr fundi (<i>Polyprion americanus</i>) Gjuhëz kanali (<i>Solea vulgaris</i>) Kocë (<i>Sparus aurata</i>)			
Pekten (<i>Pecten jacobaeus</i>) Vongola verace (<i>Venerupis spp.</i>) Tartufi i detit (<i>Venus spp.</i>)	HMD	Dragat hidraulike	Të gjitha zëniet janë objekt i detyrimit të zbarkimit
Skampi (<i>Nephrops norvegicus</i>) Astakua (<i>Homarus gammarus</i>) Aragostat (<i>Palinuridae</i>) Mormuri i egër (<i>Pagellus acarne</i>) Spalcë e kuqe (<i>Pagellus bogaraveo</i>) Pagri (<i>Pagellus erythrinus</i>) Pagri (<i>Pagrus pagrus</i>) Sargu bishtëzi (<i>Diplodus annularis</i>) Sharan (<i>Diplodus puntazzo</i>) Sargu (<i>Diplodus sargus</i>) Sargua (<i>Diplodus vulgaris</i>)	FPO, FIX, FYK	Kurthet	Të gjitha zëniet janë objekt i detyrimit të zbarkimit

VENDIM**Nr. 137, datë 19.7.2019**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 7, DATË 21.12.2018, “RREGULLORE
PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR ZGJEDHJEN E
ZËVENDËSKRYETARËVE
TË GJYKATAVE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 83, 89 dhe 92, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenin 26, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenin 11, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të nenit 7, të shtohet pikat 2, me përmbajtje si më poshtë:

“2. Kur asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t’u zgjedhur zëvendëskryetar apo zgjedhja e tij nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës është objektivist e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë